

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A- 151/14

**Prishtinë,
18 maj 2016**

Në çështjen juridike të:

M. S. R.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA 20152), i datës 21 gusht 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 18 maj 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M. S. R. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013, të datës 21 gusht 2013.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013, i datës 21 gusht 2013 për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA 20152.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 30 nëntor 2006, M. S. R. (në tekstin e mëtejshëm: Pala ankuese) në cilësinë e anëtarit të familjes së ngushtë, të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, babait të tij S. P. R., ka paraqitur kërkesë duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës nr. 1808 në sipërfaqe prej 01.14.44 ha (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar), që ndodhet në Vitomiricë, Zona Kadastrale Peje, Komuna e Pejës.
 2. Pala ankuese në kërkesën e tij ka pohuar se posedimi i pronës është humbur për shkak të rrethanave të ndërlydhura me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998/1999, duke cekur 14 qershor 1999 si datë të humbjes së posedimit.
 3. Për ta mbështetur kërkesën, ai ka paraqitur *inter alia*:
 - Aktvendimin për trashëgiminë T.nr.204/58 të lëshuar më 07 nëntor 1958 nga Gjykata e Qarkut në Peja, përmes së cilit babai i palës ankuese dhe bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore S. R. është shpallur si pasardhës ligjor i të ndjerit P. R. me 2/5 pjesë ideale nga tërë trashëgimia, e cila përbëhet nga një shtëpi dhe tokë në sipërfaqe prej 07.60.45 Ha, në Vitomiricë.
 - Aktgjykim C.nr.76/96 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Pejë, më 11 prill 1996 që vërteton se babai i palës ankuese dhe bartësi i së drejtës pronësore S. R. është pronar i një pjese të ngastrës nr.1808 në sipërfaqe prej 1.14.44 Ha, në Vitomiricë, ku i padituri PKB”Poljoprivreda” ka ndërmend t’ia njoh dhe t’ia liroj paditësit pronën në posedim, shfrytëzim të lirë dhe disponim, si dhe që paditësi të regjistrohet si bartës i së drejtës pronësore në Zyrën për Kadastër të Pronës së Paluajtshme në Peja.
 - Certifikatën e lindjes nr.10/1934 që vërteton se S.R. është djali i M. dhe P. R.
- Të gjitha dokumentet e lartpërmendura janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së.

4. AKP-ja e ka siguruar *ex officio*, fletën poseduese të pjeshme nr.410/06.02.2007 ku evidentohet P.SH.Inst.Biote.OBPB Fidanishta Bujqesore (Ndërmarrje me Pronësi-Shoqërore) si pronar i pronës së kërkuar. Në fletën poseduese ngastra nr.1808 është me sipërfaqe prej 31.74.33 Ha.
5. Njoftimi i kërkesës është bërë më 24 shkurt 2009 dhe pasqyron pronën si tokë bujqësore pa objekte (tonë/mal) e cila nuk ishte e uzurpuar.
6. Kërkesa është e pa kontestuar, pasi që asnjë palë nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit ligjor prej 30 ditëve në pajtim me dispozitën e nenit 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079.
7. Pala ankuese është kontaktuar më 03 qershor 2013 dhe ai ka thënë se është në dijeni se Aktgjykimi i dorëzuar C.nr.76/96 i lëshuar nga Gjykata Komunale në Pejë më 11 prill 1996 nuk është i plotfuqishëm dhe ai nuk e di nëse procedura e gjykatës ka përfunduar. Ai po ashtu ka thënë se familja e tij nuk ka qenë në posedim të pronës së kërkuar në vitin 1999 pasi që procedura e gjykatës ishte ende në proces dhe se humbja e pronës nuk ishte e ndërlidhur me konfliktin e armatosur gjatë viteve 1998-1999, por ka ndodhur në dekadën 1980-1990 kur prona i ishte marrë nënës së tij nga "PKB"Poljoprivreda".
8. Më 09 shkurt 2007, Ministria e Bujqësisë ka dorëzuar një letër në AKP duke e informuar se "Instituti Kosovar i Bujqësisë" është pronar i pronës së kërkuar qysh nga krijimi i tij shumë vite para konfliktit të armatosur.
9. Më 21 gusht 2013 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e vet KPCC/D/A/212/2013, e ka hedhur poshtë kërkesën. Në paragrafin 18 të vendimit, që i aplikohet kërkesës, thuhet se në bazë të llojeve të ndryshme të dokumenteve të verifikuara të dorëzuara nga paraqitësi i kërkesës (pala ankuese) apo të siguruar nga Sekretaria Ekzekutive, *ex officio*, apo në bazë të deklaratës së vet paraqitësit të kërkesës (palës ankuese), ky i fundit nuk ka arritur të tregojë se kërkesa e tij përfshinë rrethana të ndërlidhura drejtpërdrejt apo që rezultojnë nga konflikti i viteve 1998-1999. Prandaj, kërkesa është jashtë mandatit të Komisionit dhe është për tu refuzuar.
10. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 28 shkurt 2014, i cili ka paraqitur ankesë më 27 mars 2014.

Pretendimet e palës ankuese

11. Pala ankuese pohon se vendimi i ankimuar i KKPK-së përmban gabim thelbësor apo shkelje serioze të ligjit dhe është i bazuar në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Pala ankuese pretendon se si rrjedhojë e konfliktit të armatosur që ka

ndodhur në Kosovë nga 27 shkurt 1998 deri më 20 qershor 1999, ai nuk ka arritur t'i realizojë të drejtat e tij që ta kthej pronën e kërkuar. Pala ankuese gjithashtu thotë se në kohën kur është dorëzuar Aktvendimi T.nr.76/96, ai dhe babai i tij S. R. kanë jetuar në SHBA, prandaj ata nuk kanë qenë në pozitë që menjëherë ta kthejnë pronën e tyre.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

12. Ankesa është paraqitur brenda afati prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079. Gjykata Supreme ka juridiksion ndaj ankesave kundër vendimit të KKPK-së. Ankesa është e pranueshme.

Meritat e ankesës

13. Çështja për tu konsideruar në këtë rast është nëse KKPK-ja kishte juridiksion ta shqyrtonte kërkesën e M. S. R., të paraqitur në AKP më 30 nëntor 2006.
14. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë për zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me konfliktin **që përfshijnë rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999**. Kështu që, paraqitësi i kërkesës nuk duhet vetëm të dëshmojë titullin e pronësisë ndaj pronës së paluajtshme private por gjithashtu të tregojë se ai ose ajo **tani nuk mund t'i ushtrojë të drejta të tilla pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë me apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur**. Të dyja kushtet duhet të plotësohen.
15. Në lëndën aktuale, posedimi ndaj pronës është humbur gjatë viteve 1980-1990 (vet pala ankuese e pohon këtë fakt). Është e qartë se kërkesa ka të bëjë me një kontest që ka filluar para vitit 1998, dhe se nuk ka lidhje dhe nuk rezulton nga konflikti i armatosur gjatë viteve 1998/1999. Fakti se në kohën kur është dorëzuar vendimi nr.76/96, pala ankuese dhe babai i tij S.R. kanë jetuar në SHBA, nuk është i mjaftueshëm për të dëshmuar se dikush apo të dytë e kanë poseduar pronën para konfliktit, por e kanë humbur për shkak të rrethanave të konfliktit të armatosur. Dokumentet në dosje dhe

pretendimi i tij/pranimi gjithashtu tregojnë se humbja e posedimit ka ndodhur shumë kohë para konfliktit.

16. KKPK-ja me të drejtë e ka hedhur poshtë kërkesën mbi bazat se nuk kishte juridiksion për të vendosur për meritat e kërkesës pasi që pala ankuese nuk ka arritur të tregojë se kërkesa e tij përfshinë rrethana të ndërlidhura apo që rezultojnë nga konflikti i viteve 1998-1999.
17. Rrjedhimisht, ankesa në pajtim me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, është për tu refuzuar si e pabazuar dhe vendimi i KKPK-së të confirmohet për sa i përket lëndës për të cilën duhej të vendosej me këtë aktgjykim (KPA20152).

Këshillë juridike

18. Sipas nenit 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it